

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO - Me porosi direkte të Ramës, Bardhi: Ergys Agasi solli 12 deputetë në grupin e PS-së! Dorëzuar shtetin në duart e krimit
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918854/me-porosi-direkte-te-edi-rames-bardhi-ergys-agasi-s-olli-12-deputete-ne-grupin-e-ps-se-dorezuat-shtetin-ne-duart-e-krimit/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 10:21:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 10:06:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a4edcdb18b03cd0fbc631aec226c753121b9e8ffbebfcb1027440097e815a9
TEKSTI	6ccdb63326872c2e4ba0d9bf1751cc54f992c428ad3b693af6ecc56ef5b48a73
PAMJA	460665c41d0fdde5ab8f24deb70006fb46c41771895f0ab92c65859056c18e6c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	11cee66979ec98c0773097bc3d57f0b3e1a1be9ec8be7884670b675c802f8e1a
E MËPARSHMJA	67de00456c5a8627b0a4b2785b939b565aa8085fde7809f578056475bf3fd952
RRËNJJA MERKLE	34bf9fb855e0215b8384019a592b192cd8415b3fea3e8d3a2dd71c749e8b79fe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.






Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/11cee66979ec98c0773097bc3d57f0b3e1a1be9ec8be7884670b675c802f8e1a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**LAJMI I FUNDIT****LIVE - Protesta para parlamentit/ Narkopolicia dhuron protestuesit****më të lexuarat**VIDEO-‘Janë 3 orë përgjime’/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Protesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënMashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartëVIDEO-‘Hajde të tregoj unë ty’/
Përplasja me Ramën në avion, i riu: Më
kapi për qafe dhe më tha ‘të zhduk’Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë‘S’ka normalitet për situatën ku
ndodhemi’, Këlliçi: Të gjithë e kanë**Me porosi direkte të Ramës, Bardhi: Ergys Agasi solli 12 deputetë në grupin e PS-së! Dorëzuar shtetin në duart e krimit**

12:06, 24/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Kreu i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, hodhi akuza të forta në drejtim të qeverisë. Ai i bëri thirrje socialistëve të sjellin Ramën në Kuvend dhe të japë llogari se dorëzoi shtetin në duart e krimit të organizuar.

Gazment Bardhi thirrje socialisteve në Kuvend: Silleni Edi Ramen zvar ketu e të japë llogari si ia ka dorëzuar shtetin krimit të organizuar.

“Besoj që ky është një nga momentet më të vështira qoftë për parlamentin, qoftë për Republikën e Shqipërisë dhe unë e kuptoj sikletin tuaj që detyroheni që një nga çështjet më të rënda që ka ndodhur në Republikën e Shqipërisë ta trajtoni duke ju mbrojtur një e papërgjegjshme, sepse asnjë njeri i përgjegjshëm në këtë sallë nuk mund të marrë guximin të vijë të flas këtu për 45-ën ku sot në vitin 2026 Shqipëria një vend anëtar i NATO-s, Shqipëria vend kandidat për Bashkimin Europian, është provuar diçka të cilën ne ju kishim paralajmëruar.

Po kështu përqeshnit, bënit historinë e shtetit ku ne ju thamë që Flora Hyseni është emërim i Ergys Agasit në shërbimin informativ të shtetit për t'i shërbyer grupeve kriminale nga kjo foltore.

Ju thatë ku i gjetët këta? Nuk e bën Edi Rama këtë. Edi Rama ka zgjedh më të mirë. Ja që doli që është e vërtetë. Ku e keni Edi Ramën sot? Fshihet pa asnjë të papërgjegjshme që nuk mban përgjegjësi. Çfarë thotë? Me ligj. Nuk mban përgjegjësi zonja. Nuk bë përgjegjësi me ligj për atë që thotë, sepse është zyrtarisht e papërgjegjshme, sepse një zyrtar i përgjegjshëm ishte zëvendës kryeministria këtu.

S'foli asnjë fjalë, sepse nuk mund të vijë këtu dhe të thotë që ne jemi

me të mirat kur shpreja e shprehim informativ të shtetit ju vetëm
ndihmonte kreun e një organizate kriminale t'i arratisj drejtësisë, por i
thoshte thua çunave të veproj lehtë sot, lirshëm sot, se unë për ty fik
radarët e shtetit.

E në fakt ja ka fikur radarët shtetit, ka fikur dhe radarët tuaj, sepse
zyrtarisht shteti shqiptar është ndërruar në narkoshtet. Nëse shefin e
shërbimit, nëse drejtorin e përgjithshëm, nëse kryeministrin e vendit e
urdhërojnë grupet kriminale dhe grupet e trafikut të drogës, këtu nuk
ka më shtet. Ky është antihetiti që keni ndërtuar ju. ku narkosi cakton
ministrat, deputetët, drejtorët e përgjithshëm policisë, drejtorët e
agjencive kryesore në vend, drejtorin e kadastrës, është emërim po i
këtij zotërisë. Pra ju keni dorëzuar me vetëdije grupeve kriminale
shtetin shqiptar, sepse e dini që janë këto grupe kriminale që ju
mbajnë ju.

A nuk ishte Ergys Agasi që të paktën ka sjellë në këtë sallë 12
deputetë të grupit parlamentar të Partisë Socialiste me porosi direkte
të Edi Ramës, qark për qark se kush do votohej nga Xhabaftët në
Tiranë, kush do votoj nga Suel Çela në Elbasan, kush do votoj nga
Troplinët në Durrës, kush do votojë nga Bajrat në Shkodër, e ka me
porosi direkte të Edi Ramës P SMS nuk e dini ju këtë.

Po ju e dini këtë dhe nuk jeni të gjithë në këtë sallë kjo kategori. Iku
Fatmir Xhafaj tani nga salla se e kisha një pyetje drejtpërdrejtë për të.
Ka qenë ministër drejtësie në këtë republikë dhe një ministër
drejtësie, ish-ministër drejtësie nuk mund të dalë kurrë dhe të thotë
kjo është çështje e drejtësisë. Jo, nuk është çështje e drejtësisë.

Drejtësia nuk fshin as video, nuk gris as prova, i ka dalë përpara dhe
e ka hetuar. Edhe pse opozita me në krye kryetarin e vetë, kryetarin e
grupit, çdo deputet i këtij grupi ka ardhur në këtë sallë dhe ka thënë
shërbimi informativ i shtetit është në dorën e krimit të organizuar.

Nuk veproj drejtësia, por kur i del përpara me SMS, me video, me
foto, çfarë prisni ju? Prokurorët, shërbëtorët tuaj t'i grisin, të shkojnë
në burg Vlorë, Hysenit edhe Argasit. Nuk e bën asnjë prokuror sado i
kapur të jetë një gjë të tillë. Po as ju s'keni vepruar edhe pse një pjesë
prej jush nuk janë kjo kategori dhe thirrja ime sot është për ata. Ka
këtu deputetë që ka nga 20 vite që kanë ardhur me votë qytetarëve.
Mos e pranoi këtë realitet. Ata që po ju turpërojnë nuk janë socialistë.
s'kanë asnjë lidhje me Partinë Socialiste. Pse nuk ngriheni ju t'i thoni
kjo sëmundje me krye Edi Ramën jashtë Partisë Socialiste? Sepse
krimi nuk ka punë me Partinë Socialiste. Partia Socialiste ashtu si
Partia Demokratike janë asete kombëtare me të mirat dhe të këqijat e
veta në këto 35 vite. Si mund ta shndërroni ju në organizatë kriminale
një parti që ka qeverisur vendin për vite të tëra. Ka bërë gjatë këtyre 14
viteve shumë gjëra të këqija, po më parë ka bërë dhe gjëra të mira ku
një pjesë prej jush kanë qenë dhe ministra. Si mund ta pranoi ju
kokulur që të vijë këtu një ministër edhe thotë s'ka ndodhur asgjë.
Shërbimi informativ i shtetit i ulur në prerjen e krimit të organizuar dhe
ju thoni s'ka ndodhur asgjë. Si s'ka ndodhur asgjë. Çfarë duhet
ndodhur më që të vijë Edi Rama këtu të japë llogari dhe të japë
dorheqjen? Çfarë duhet ndodhur më në këtë vend? Çfarë prisni ju?
Ky është momenti zoti kryetar që ju si numri dy i shtetit se ju dëgjova
që thate përfundoheni ju lutem.

Po e keni ju vërtetë jeni zgjedhur me votat e grupit parlamentar të PS-
së. Po këtu përfaqësoni Kuvendin e Shqipërisë dhe kjo është
republikë parlamentare. Dhe në një republikë parlamentare
kryeministri sillet zvar të japë llogari kur i ka dorëzuar shtetin krimit të
organizuar. Dhe kjo është detyra jote sot dhe këtë do bërë se ndryshe
këtu nuk ka seancë.

pranuar skandalin e Romë Tetet, Rama
jo!

'Garancia e plotë' e Ramës dhe
përgjegjësia e tij politike për Vlorë
Hysenin

'Rama, një bandit që vjedh i
pashqetësuar', Blushi: 'KAYO' e
rivërtetoi se shteti është mafie sot!

Nata e 6 në shesh kundër dënimit të ish-
krerëve të UÇK-së/ Protestës i bashkohet
edhe Përparim Rama

© SYRI.net

Lexo edhe:



Reforma e Ramës/ Këshilli Bashkiak i Përrenjasit votoi kundër
bashkimit me Bashkinë e Librazhdit



'Çfarë duhet t'ju bëjë më Rama? Ju kanë kthyer në organizatë
kriminale'/ Këlliçi: Agasi ju ka marrë zvarrë



'Ky është narkoshtet', Noka: Një shyllë e ka Ron Yeffet, me
Ergys Agasin dhe Klod Allajbeun



TË NGJASHME



Shteti në gjunjë para krimit të organizuar, narkopolicia dhuron protestuesit, qytetari i shtrirë në tokë humb ndjenjat



E pyetën për Agasin/ Vlora Hyseni shantazhon gazetarët: Siç ti në dhomat e hotelit me agjentët serb...



Analiza e BIRN: Arrestimi i drejtueses së SHISH, goditje e madhe për reputacionin e vendit anëtar të NATO-s



Berisha-ministres Ismaili: Keni kaluar nga zyra e Ergysit? Të ka shërbyer ajo zyre për t'u ngjitur si deputete?



Ku është zhdukur Rama? – Mungon në drekën me Kallas, Feriti në vend të tij



Zhupa: Jeni Partia e Skandaleve! Kthyet shtetin në Narko-shtet! Rama të japë dorëheqjen, qeveri tranzitore



'Parlamentarizmin e zhbëjnë krimi, korrupsioni dhe pushteti i Ramës', Mediu: Ka rënë piramida e sigurisë!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.